



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



## **Drejtoria për Zhvillimit Rural**

### **THIRRJE PËR APLIKIM PËR PJESËMARRJE NË TREGUN MOBIL**

Ftohen të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për pjesëmarrje në tregun mobil në Komunën e Prishtinës për ekspozim të produkteve artizanale.

#### **Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët:**

1. Përparësi do të kenë aplikuesit nga Komuna e Prishtinës;
2. Aplikuesit që të vetmin burim të të ardhurave e kanë shitjen e artizanateve;
3. Në kushte të barabarta gratë dhe grupet e marginalizuara do të kenë përparësi;
4. Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
5. Nuk mund të jetë përfitues aplikuesi, nëse ndonjë anëtar i bashkësisë familjare është në shfrytëzim të ambienteve apo objekteve të Komunës me qëllim shitje apo ekspozimi të artizanaleve;
6. Përfituesit nuk kanë të drejtë ekspozimi të produkteve përveç artizanaleve.

#### **Dokumentacioni i kërkuar:**

1. Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Dëshmi lidhur me vendbanimin - fatura e ujit, rrymës;
3. Deklarata nën betim.

### **VËREJTJE**

Nëse komisioni parasheh të nevojshme të kërkoj dokumente shtesë të cilat mundësojnë përzgjedhjen e përfituesve aplikantët janë të obliguar t'i sjellin brenda afatit, në të kundërtën humbin të drejtën për të qenë përfitues.

**Data e aplikimit nga 26/04/2024 deri 03/05/2024**